



ALIMADHI & KACA
LAW CONSULTING

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 29.02.2024

VENDIM ASAMBLEJE

Lënda: Ndryshim neni ne statutin e shoqerise.

Sot më datën 29.02.2024 pranë selisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **ALIMADHI & KACA LAW CONSULTING**, u paraqitën ortakët e shoqërisë si më poshtë:

1. Z. Eridjon Alimadhi, Ortak i shoqërisë zotërues i 1 kuote me 50% të pjesëve të kapitalit
2. Z. Denis Kaca, Ortak i shoqërisë zotërues i 1 kuote me 50% të pjesëve të kapitalit

REND DITE:

Z. Eridjon Alimadhi dhe Z. Denis Kaca në cilësinë e ortakëve të shoqërisë **ALIMADHI & KACA LAW CONSULTING** do të zhvilloje mbledhjen me rend dite si më poshtë:

1. Ndryshim neni ne statutin e shoqerise.

VENDIM:

Në shoqërine me përgjegjësi të kufizuar **ALIMADHI & KACA LAW CONSULTING** në kushtet kur kjo shoqëri po zhvillon aktivitet, në mbledhjen e kësaj date 29.02.2024, ortakët e kësaj shoqërie vendosen:

1. Ndryshimin e Neni 14 “Kompetencat e Administratorit”.
2. Ishte:

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme

[Signature]
2024

[Signature]

për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

3. Behet:

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;


dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

f) ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e


2024



shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.


Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë me vete, veprojnë pa kufizim dhe me te gjitha tagrat e përfaqësimit ne statut.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.


Ortakët e shoqërisë
ALIMADHI & KACA LAW CONSULTING

Eridjon Alimadhi



2024

Denis Kaca



ALIMADHI & KACA LAW CONSULTING
M41402035J

Njësia administrative Nr.4, Rruga Bardhyl, Pallati Nr.8 Hyrja Nr. 1, Kati i dytë, Apartamenti Nr.3, Tiranë.